Pml.nr.152/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetar kolegji dhe gjyqtarëve: Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve: F.Z., për shkak të veprave penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPRK-së, mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 e ndëshkueshme sipas nenit 2.8 të Ligjit 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit dhe falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, A.N., për shkak të veprave penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPRK-së dhe mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, L.A., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe A.H., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve F.Z. dhe L.A., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.120/2015 të datës 26.07.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.468/2018 të datës 14.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.06.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit L.A., kurse sipas detyrës zyrtare edhe për pjesën që ka të bëj me të dënuarit F.Z., A.N. dhe A.H., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.59/2019 të datës 26.02.2019 dhe çështja i kthehet asaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.120/2015 të datës 26.07.2018, të dënuarit: F.Z., e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPRK-së, mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 e ndëshkueshme sipas nenit 2.8 të Ligjit 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit, A.N., për shkak të veprave penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPRK-së dhe mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, L.A., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe A.H., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe i ka gjykuar: F.Z. me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 10 (dhjetë) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 12.000,00 (dymbëdhjetë mijë) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 13.03.2013 deri me datë 11.03.2014, A.N., me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës prej pesë vite pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 13.03.2013 deri me datë 17.12.2013, L.A., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 2 (dy) muaj, A.H., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 27.03.2013 deri me datë 08.11.2013. Janë obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor secili në shumë prej nga 20 € dhe shpenzime të procedurës penale në shumë prej 100 €.

Me të njëjtin aktgjykim F.Z., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale ndihmë në falsifikimin e dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.59/2019 të datës 26.02.2019, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, mbrojtësve të të dënuarve F.Z. dhe L.A., ka refuzuar akuzën ndaj të pandehurit A.H., për veprën penale

falsifikimi i dokumentit nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar A.F., e ka hudhur si të palejuar, kurse pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e paprekur.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit L.A., av. Xh.M. nga P., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimin mbi dënimin, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, t'i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë apo të ndryshoj aktgjykimin e formës së prerë dhe të dënuarin ta liroj nga akuza;

- mbrojtësi i të dënuarit F.Z., av. R.M. nga V., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.112/2019 të datës 21.05.2019, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit L.A. thekson, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, pasi që në përbërje të kolegjit të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtarja Hava Haliti e cila po ashtu ka marrë pjesë në cilësinë e anëtarit të kolegjit me rastin e vendosjes përkitazi me kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimit të provave sipas të njëjtës çështje penale.

Më tutje pretendohet se me rastin e shqiptimit të dënimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është shkelur ligji penal pasi që në rastin konkret ndaj të dënuarit nuk është aplikuar ligji më i favorshëm përkatësisht dispozita që ka të bëj me ndihmën në kryerjen e veprës penale. Edhe pse dispozitat e veprës penale të mashtrimit parashohin dënim të njëjte të dy kodet penale edhe ai i cili ishte në fuqi me rastin e kryerjes së veprës penale e po ashtu edhe ligji i ri, megjithatë për kryerësin e veprës penale më e favorshme është dispozita e ndihmës e ligjit të ri pasi që dispozita e nenit 33 par.1 të KPRK-së është më e favorshme meqë ka përcaktuar se ndihmësi dënohet me dënim më të butë se kryerësi. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur të aplikoj dispozitat e ligjit më të favorshëm përkatësisht nenin 33 të KPRK-së dhe jo dispozitën e nenit 25 të KPK-së e me këtë ka shkelur ligjin penal.

Mbrojtësi i të dënuarit F.Z. në kërkesën e tij thekson se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale përkatësisht nenit 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së, meqë aktgjykimet janë të paqarta dhe të pakuptueshme dhe si të tilla nuk përmbajnë arsye përkitazi me faktet vendimtare. Arsyetimi i aktgjykimeve është në kundërshtim të plotë me provat dhe deklarimet e dëshmitarëve të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë specifikuar veprimet konkrete të të dënuarit sidomos përkitazi me pikën e parë dhe të dytë të dispozitivit të aktgjykimit. Duke u bazuar në dispozitivin e pikës së parë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i dënuari F.Z., është shpallur fajtor dhe është gjykuar për veprën penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së edhe pse në veprimet e tij janë të formuara elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve pasi që i dënuari vetëm kishte përgatitur dokumentet përkatëse kurse i dënuari tjetër A.N., duke u paraqitur si A.F., kishte shkuar në bankë dhe kishte bërë legalizimin e dokumentacionit përkatësisht zëvendësimin e librezave të vjetra me libreza të reja, për më tepër i dënuari F.Z., fare nuk kishte shkuar në bankë për ndërrimin e librezave. Të njëjtat lëshime janë bërë edhe në dispozitivin e dytë të aktgjykimit me të cilin i dënuari F.Z., është shpallur fajtor për veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, kinse ka bërë tërheqjen e parave, mirëpo në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk theksohet fakti se paratë i dënuari F.Z., i kishte tërhequr me të dënuarin tjetër A.N.

Në kërkesë pretendohet po ashtu se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë aktgjykimet e tyre i kanë marrë në kundërshtim me dispozitën e nenit 384 par.1 nënpar.1.8 të KPPK-së, pasi që të dy aktgjykimet bazohen në provë të papranueshme përkatësisht janë të bazuara në dëshminë e dëshmitarit – të dëmtuarit B.M., pasi që dëshmia e tij në shqyrtimin gjyqësor ishte lexuar në mungesë të tij. Dëshmia e këtij dëshmitari ishte dhënë gjatë procedurës hetimore në polici dhe prokurori, ashtu që mos prezenca e tij në shqyrtimin gjyqësor e ka kufizuar mbrojtjen pasi që nuk ka mundur që ti parashtroj pyetje pasi që nuk është ftuar nga gjykata përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtar edhe pse është vërtetuar se gjendej jashtë vendit.

Më tutje pretendohet se duke marrë për bazë faktin se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë bazuar në provat e administruara e kanë shpallur fajtor të dënuarin F.Z. edhe pse nuk është vërtetuar se në veprimet e tij janë formësuar elementet e veprave penale për të cilat është shpallur fajtor me çka rezulton se të dy gjykatat kanë bërë shkelje të ligjit penal.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit L.A. është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit L.A. është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, sepse në marrjen e këtij vendimi ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohej.

Siç rezulton në shkresat e lëndës në kolegjin penal të gjykatës së shkallës së dytë sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit L.A. me aktgjykimin të evidentuar PAKR.nr.59/2019 të datës 26.02.2019, ka vendosur gjyqtarja Hava Haliti, e cila ka qenë dashur të përjashtohej, pasi që në

të njëjtën çështje penale ka marrë pjesë edhe në kolegjin penal i cili ka vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit F.Z., gjatë procedurës përkitazi me kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.823/2016 të datës 24.11.2016.

Me dispozitën e nenit 39 par.2 të KPPK-së, është përcaktuar se "Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues", andaj në rastin konkret në kundërshtim me dispozitën e lartcekur rezulton se në shqyrtimin e ankesës ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në shkeljen e potencuar më lartë nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara meqenëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet, e që kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së dhe si e tillë kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Duke pasur parasysh faktin se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur vetëm në dobi të të dënuarit L.A., Gjykata Supreme e Kosovës, konform dispozitës së nenit 436 par.2 të KPPK-së, ka aplikuar institutin *beneficium cohaesionis*, meqë shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të dënuarit L.A., nuk janë të natyrës personale dhe shkojnë në dobi edhe për të dënuarit tjerë F.Z. dhe A.N., të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë, ose nuk kanë paraqitur kërkesë në këtë drejtim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.152/2019, më datë 05.06.2019

Procesmbajtësja, Kryetarja e kolegjit,

Mirlinda Mejzini-Simnica Valdete Daka